



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më 21 korrik 2020, miratoi si vijon:

RREGULLORE NR.03/2020
PËR ADMINISTRIMIN E LËNDËVE PËRMES SISTEMIT ELEKTRONIK NË
ZYRËN PËR MBROJTJE DHE NDIHMË VIKTIMAVE

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurën e pranimit, regjistrimit, ndarjes dhe administrimit të lëndëve përmes sistemit elektronik në Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen nga stafi i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet si më poshtë:

KPK.....Këshilli Prokurorial i Kosovës;
KGJK.....Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
PSH Prokuroria e Shtetit;
ZMNV.....Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave;
PK.....Policia e Kosovës;
LN.....Linja Ndihmëse;
QPS.....Qendra për Punë Sociale;

ANJF.....Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
QMGF.....Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve;
SHPS.....Strehimorja për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore;
QKUK.....Qendra Klinike Universitare e Kosovës;
QKMF.....Qendra e Mjekësisë Familjare;
QSHM.....Qendra e Shëndetit Mendor;
MASHT.....Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
MPMS.....Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
OJQ.....Organizatrat Joqeveritare;
ABGJ.....Agjencia për Barazi Gjinore;
OAK.....Oda e Avokatëve të Kosovës;
SEZMNV.....Sistemi Elektronik i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
SHKRESË.....Të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në një proces gjyqësor;
LËNDË...Tërësi e të gjitha akteve apo shkresave, të cilat kanë të bëjnë me të njëjtën çështje apo me të njëjtën procedurë;
DOSJE.....I tërë dokumentacioni lidhur me një çështje procedurale para gjykatës.

Neni 4 Pranimi i lëndës

1. Lënda në ZMNV pranohet nga policia, prokuroritë, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pala dhe institucionet e tjera.
2. Lëndët regjistrohen nga mbrojtësit e viktimave të zyrave regjionale në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.
3. Mbrojtësi i viktimave pasi regjistron rastin në dosjen e lëndës shënon numrin e lëndës të gjeneruar nga Sistemi Elektronik i ZMNV-së, si dhe shtypë letërkonfirmimin nga Sistemi Elektronik i ZMNV-së.

Neni 5 Regjistrimi i lëndës në sistem

1. Regjistrimin e lëndës në Sistemin Elektronik të ZMNV-së e bënë mbrojtësi i viktimave në zyrën regjionale.
2. Regjistrimi i rastit në Sistemin Elektronik të ZMNV-së bëhet si rast i ri, duke përfshirë të dhënat më poshtë:
 - 2.1. Të dhënat personale të viktimës;
 - 2.2. Të dhënat personale të kryerësit;

- 2.3. Të dhënat për lëndën, veprën penale dhe fazën e procedurës penale dhe civile dhe
- 2.4. Të gjitha veprimet e tjera që kryhen nga mbrojtësi i viktimave.
3. Sistemi Elektronik i ZMNV-së mund të ndërlidhet me sisteme të institucioneve të tjera me qëllim të shkëmbimit të të dhënave për rastet.

Neni 6 **Mënyra e ndarjes së lëndëve**

1. Ndarja e lëndëve përmes Sistemit Elektronik të ZMNV-së të mbrojtësit e viktimave bëhet në mënyrë automatike dhe/ose manuale.
2. Të gjitha lëndët e pranuar nga mbrojtësi i viktimave bëhen sipas radhës së arritjes, regjistrohen në Sistemin Elektronik të ZMNV-së dhe pastaj nëpërmjet sistemit bëhet ndarja e tyre.

Neni 7 **Ndarja automatike**

1. Ndarja automatike e lëndëve të regjistruara në sistemin elektronik ka për qëllim ndarjen e barabartë të lëndëve në punë të mbrojtësve të viktimave në kuadër të zyrës regjionale përkatëse.
2. Sistemi Elektronik i ZMNV-së e bënë ndarjen automatike të të gjitha lëndëve, duke caktuar mbrojtësin e viktimave, i cili për momentin është më pak i ngarkuar sesa të tjerët.
3. Në rastet kur mbrojtësi i viktimave nuk paraqitet në punë për një periudhë kohore prej pesë (5) ditësh pune e më tepër për arsye të ndryshme (pushim vjetor, mjekësor, trajnime, shkollim dhe të tjera), sistemi do t'i përjashtojë nga shpërndarja automatike e lëndëve.
4. Mbikëqyrësit regjionalë të ZMNV-ve do të jenë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në Sistemin Elektronik të ZMNV-së që ndërlidhen me pushimet e mbrojtësve të viktimave sipas paragrafit 3.

Neni 8 **Ndarja manuale**

1. Mbikëqyrësi regjional mund të ushtrojë të drejtën e shpërndarjes së lëndëve në mënyrë manuale në raste të caktuara si në vijim:
 - 1.1 Lënda e natyrës urgjente, e cila për nga afati kërkon trajtim të shpejtë, i ndahet mbrojtësit të viktimave nga mbikëqyrësi i regjionit përkatës. Këto lëndë nuk i

nënshtrohen procesit të shpërndarjes së Sistemit Elektronik të ZMNV-së në mënyrë automatike.

1.2 Në rastet kur mbrojtësi i viktimave është i kërcënuar nga kryesi, atëherë mbikëqyrësi i zyrës dhe menaxhmenti i ZMNV-së shqyrtojnë mundësinë për caktimin e një mbrojtësi të viktimave nga zyra e regjionit përkatës apo nga zyra e regjionit tjetër në mënyrë manuale nga sistemi elektronik.

1.3 Në rastet kur viktimat kërkon që të përfaqësohet nga mbrojtësi i njëjtë si më parë, atëherë mbikëqyrësi mund të vendosë për aprovimin apo refuzimin e kërkesës.

Neni 9 Dosjet e lëndës

1. Të gjitha shkresat në kuadër të lëndës regjistrohen, skanohen dhe ngarkohen në mënyrë elektronike në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.
2. Mbrojtësi i viktimave i zyrës regjionale përkatëse shënon numrin e lëndës së gjeneruar në dosjen e lëndës nga Sistemi Elektronik i ZMNV-së dhe ia bashkëngjijtë letërkonfirmimin, e cila duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi dhe pranuesi (mbrojtësi i viktimave).
3. Shkresat e pranuar përmes e-mail-it zyrtar dhe përmbajtja e e-mail-it duhet të printohen dhe t'i bashkëngjiten dosjes së lëndës si dëshmi e pranimit të shkresës së lëndës.

Neni 10 Radhitja e shkresave në kuadër të dosjes

1. Radhitja e shkresave të lëndëve bëhet në mënyrë kronologjike, sipas datës së pranimit dhe hartimit të shkresës.
2. Të gjitha shkresat që gjinden në lëndë duhet të përmbajnë numrat, në mënyrë që tregojnë numrin e faqeve për secilën shkresë konkrete.

Neni 11 Lëndët urgjente

Lëndët e natyrës urgjente përfshirë dhe lëndët me urdhrin mbrojtës emergjent duhet të shënohen si "URGJENTE" në faqen e parë të dosjes së lëndës dhe në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.

Neni 12 Trajtimi i dosjes

1. Dosja e lëndës, shkresat dhe materialet e tjera nuk duhet lënë pa mbikëqyrje gjatë

orarit zyrtar të punës.

2. Pas orarit zyrtar të punës, materialet e theksuara në paragrafin 1 duhet të mbyllën në hapësirat e përshtatshme për ruajtjen e tyre.
3. Dosja fizike e lëndës duhet të jetë identike me dosjen elektronike të lëndës në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.

Neni 13

Korrigjimi i gabimeve në sistem

Mbrojtësi i viktimave i ngarkuar me lëndën e caktuar mund të bëjë përmirësime në Sistemin Elektronik të ZMNV-së për shkak të regjistrimit të gabuar dhe për të njëjtën duhet të njoftohet mbikëqyrësi i zyrës regjionale.

Neni 14

Shqyrtimi i juridiksionit

1. Mbrojtësi i viktimave shqyrton lëndën dhe juridiksionin territorial të rasteve sipas ligjit.
2. Nëse mbrojtësi i viktimave konstaton që rasti i pretenduar është brenda juridiksionit të një zyre tjetër të ZMNV-së, ai/ajo me aprovim të mbikëqyrësit të zyrës dhe njoftim të Menaxherit të ZMNV-së, përmes sistemit elektronik do ta referojë lëndën në zyrën kompetente.

Neni 15

Dorëzimi i shkresave

1. Lista e shkresave që duhet të dorëzohen në gjykatë, prokurori dhe institucione të tjera përfshinë:

1.1 Kërkesa për urdhrin e mbrojtjes;

1.2 Ankesat;

1.3 Përgjigjen në ankesë;

1.4 Propozimet;

1.5 Formulari i kërkesës për kompensim;

1.6 Deklarata mbi dëmin;

1.7 Të tjera.

Neni 16
Thirrja për seanca

1. Mbrojtësit e viktimave pas pranimit të ftesës brenda afatit ligjor janë të obliguar të marrin pjesë në të gjitha seancat sipas mandatit dhe përgjegjësi të tyre.
2. Në raste se mbrojtësi i viktimave nuk mund të marrë pjesë në seancë duhet ta njoftojë mbikëqyrësin, i cili pas njoftimit cakton zëvendësuesin (mbrojtësin e viktimave).
3. Sistemi Elektronik i ZMNV-së do të paralajmërojë orarin e seancave të planifikuara për rastin përkatës.

Neni 17
Kujdestaria

Mbikëqyrësi i zyrave regjionale përmes Sistemit Elektronik të ZMNV-së cakton kujdestarin sipas radhës për periudhë kohore 24h/7 ditë në javë.

Neni 19
Pezullimi i rastit

Pezullimi i rastit në procedurë bëhet sipas rrethanave, të cilat i ka paraparë Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Pezullimi i rastit do të reflektojë edhe në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.

Neni 20
Mbyllja e rastit

1. Mbyllja e rastit bëhet në rastet kur:
 - 1.1 Viktima heqë dorë;
 - 1.2 Refuzon të drejtat dhe shërbimet e ZMNV-së;
 - 1.3 Shtirren mjetet juridike;
 - 1.4 Përcaktohet ekzistimi i konfliktit të interesit dhe
 - 1.5 Rrethana të tjera që mund të përbëjnë shkak për përfundim të shërbimeve.
2. Në rast të heqjes dorë nga viktima gjersa rasti është ende në gjykatë, mbrojtësi i viktimave ia paraqet gjykatës njoftimin për ndërprerjen e shërbimeve të mbrojtësit të viktimave dhe jep arsyet e ndërprerjes.
3. Mbyllja e rastit duhet të regjistrohet në Sistemin Elektronik të ZMNV-së dhe e njofton menaxhmentin e ZMNV-së për ndërprerjen e rastit.

Neni 21
Rihapja e rastit

Rihapja e rastit në Sistemin Elektronik të ZMNV-së bëhet me kërkesën e viktimës dhe sipas rrethanave të përcaktuara me ligj.

Neni 22
Shqyrtimi i rastit nga menaxhmenti

Menaxheri i ZMNV-së do të ketë qasje të plotë në sistemin elektronik dhe do të mund të shqyrtojë secilin rast.

Neni 23
Mjetet juridike

1. Mbrojtësit e viktimave kanë të drejtë në ushtrimin e mjeteve juridike çdo herë kur shkelen të drejtat e viktimave të përcaktuara sipas ligjit.
2. Të gjitha veprimet shtesë të mbrojtësve të viktimave do të regjistrohen në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.

Neni 24
Administrimi i rasteve të trajtuara nga linja ndihmëse

1. Linja ndihmëse telefonike falas, e vendosur në ZMNV, e cila është funksionale 24 orë dhe 7 ditë në javë, e cila udhëzon, këshillon viktimat e krimit dhe thirrësit e tjerë për të drejtat e tyre dhe referon rastet për ndihmë të mëtutjeshme te mbrojtësit e viktimave dhe institucionet e tjera relevante, do të operojë përmes Sistemit Elektronik të ZMNV-së.
2. Linja ndihmëse falas për viktimat e krimit pranon thirrjet përmes telefonit dhe këto thirrje i regjistron në Sistemin Elektronik të ZMNV-së.
3. Çdo thirrje e pranuar nga linja ndihmëse në Sistemin Elektronik të ZMNV-së regjistrohet si rast i veçantë dhe vendoset në kategoritë e caktuara të veprave penale të listuara në sistem dhe dokumenton veprimet e ndërmarra për secilën thirrje.
4. Çdo thirrje/rast i pranuar në linjën ndihmëse dhe i referuar te mbrojtësi i viktimave për asistencë të mëtutjeshme fillimisht regjistrohet si rast i veçantë i linjës ndihmëse.
5. Çdo veprim i ndërmarrë për rastin e referuar nga linja ndihmëse do të regjistrohet ndaras si rast i veçantë nga mbrojtësi i viktimave, te i cili është referuar rasti.

Neni 25
Raportet

1. Të gjitha raportet e nevojshme sipas periudhës së caktuar kohore gjenerohen nga Sistemin Elektronik të ZMNV-së.
2. Sistemi elektronik do të mundësojë gjenerimin e raporteve elektronike për thirrjet e pranuar dhe rastet e asistuar nga linja ndihmëse telefonike.

Neni 26
Arkivimi

Pas përfundimit të afateve ligjore të përcaktuara në rregulloren e veçantë bëhet arkivimi i lëndëve në aspektin fizik dhe atë elektronik të ZMNV-së.

Neni 27
Përfundimi i vitit

Pas mbarimit të vitit kalendarik, numri unik i lëndës në Sistemin Elektronik të ZMNV-së rifillon në mënyrë automatike sipas shembullit - Viti: 0000001.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Kapitulli III i Rregullores mbi mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 tetor 2020.

Prishtinë, më 21 korrik 2020


Bahri Hyseni
Kryesues i Këshilli Prokurorial të Kosovës